




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu-Alija, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL	Datë: 12.08.2026 VI-020-532
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

vendimin Nr. 01-353/01-0031342/26 për caktimin e lokacionit për objektin e ndërmarrjes publike lokale Eko-Natyra SH.A Skenderaj

I miratuar më datë: 31.07.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 05.08.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

ARSYETIM

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2026, ka miratuar, vendimin Nr. 01-353/01-0031342/26 për caktimin e lokacionit për objektin e ndërmarrjes publike lokale Eko-Natyra SH.A Skenderaj.

MAPL, konstaton se akti i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt, është i bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, 26, paragrafi 1, paragrafi 2, dhe nen paragrafi 2.1, i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Shfrytëzimi i pronës së paluajtshme të komunës për nevoja të komunës

Komuna ka të drejtë të jep pronën në shfrytëzim, për institucionet sajë vartëse apo të bëjë destinimin e pronës për nevojat e sajë, pa i zhvilluar procedurat e përcaktuara më ligjin përkatës për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale.

Institucionet vartëse për të cilat komuna nuk zhvillon procedurën e përcaktuar për dhënien e pronës komunale janë: Ndërmarrjet publike lokale, sipas Ligjit përkatës për ndërmarrjet publike.

Vendimi është miratuar me 21 vota për, 0 kundër dhe 2 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republiken Kosova
Republic of Kosovo

01-353/01-003142/26
05-08-2026



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Kuvendi i Komunës/ Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Bazuar në nenin 11, 12 paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), dhe nenin 14, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nenin 26 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal, si dhe Hartën Zonale të Komunës së Skenderaj dhe nenin 14 paragrafi 1, 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt me Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, bazuar në kërkesën e NPL Eko – Natyra SH.A. NR. 02-463/01-0014728/26 të datës; 24.04.2026, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën; 31.07.2026, miratoi këtë:

VENDIM

(Për caktimin e lokacionit për Objektin e Ndërmarrjes Publike, Lokale Eko – Natyra SH.A, Skenderaj)

Neni 1

Miratohet propozim – vendimi Nr.02-353/010027287/26, i datës 15.07.2026, Për caktimin e lokacionit për Objektin e Ndërmarrjes Publike, Lokale Eko – Natyra SH.A, Skenderaj.

Neni 2

I Caktohet: Lokacioni për Objektin e Ndërmarrjes Publike, Lokale Eko – Natyra SH.A, Skenderaj, të cilës i jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej **457.99 m²**, e ndarë nga sipërfaqja e përgjithshme **4596 m²**, parcela Nr . P-72015041-01402-1, Zona kadastrale Llaushë, Komuna Skenderaj.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme është për ushtrimin e funksionimit publik të Ndërmarrjes Publike, Lokale Eko – Natyra SH.A, Skenderaj.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 30 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit të protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit të tij në ueb-faqen e komunës.

Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit;
- 1x1 Zyrës së Kryetarit;
- 1x1 DGJKP-së;
- 1x1 NPL, Eko- Natyra,
- 1x1 MAPL-së
- 1x1 Dosjes.

